



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në seancën e 47 të mbajtur me datë 31.03.2021 morri:

VENDIM

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 09-4200/1 me datë 05/09/2019, sepse akuzat nga denoncimi se ekziston gjendje e konfliktit të inteersave gjatë realizimit të procedurës për Konkurs publik nr. për punësim të nënpunësit administrativ në komunën e, në vendin e punës Kështilltarë – planifikues në Njësinë për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullim të tokës ndërtimore, veprime komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor, nuk janë vërtetuar, me çka Komisioni shtetëror e ndërpret veprimin.

Lënda me numër 09-4200/1 me datë 05.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-4200 me datë 05.19.2019, është e formuar pas denoncimit nga parashtrues i njohur: nga fshati, komuna me akuza se për nevojat dhe me kërkesë të Komunës nga ana e Agjensionit për administratë ëshë shpallur konkurs numër për punësim të nënpunësit adminsitartiv në këtë komunë në vendin e punës Kështilltarë – planifikues në Njësinë për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullim të tokës ndërtimore, veprime komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor. Në konkurs u paraqitën dy kandidatë nga të cilët njëri është vet parashtruesi i këtij denoncimit. Është formuar komision për selektim, në të cilën si anëtar është emëruar bashkëshorti i njërit nga kandidatët, i punësuar në Komunës e në vendin e punës udhëheqës i Njësisë për urbanizëm, për nevojat e së cilës është shpallur konkursi për plotësim të vendit të punës. Vendimin për formim të komisionit është ndryshuar dhe si anëtarë në vend të bashkëshortit të njërit nga kandidatët është emëruar anëtarë tjetër në njësinë për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullim të tokës ndërtimore, veprime komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor. Parashtruesi i denoncimit, i cili njëherit ka konkuruar në këtë konkurs, thekson se duke pasë parasyshë se anëtari i ri i emëruar në komisioni është i vendosur në njësinë e njëjtë, ku udhëheqës është bashkëshortja e kandidatit tjetër të paraqitur, edhe më tej ka konflikt të interesave. Parashtruesi mendon se anëtari i emëruar, i punësuar në këtë njësi është në gjendje të konfliktit të interesave, nuk e ka informuar institucionit në ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesave, mirëpo nuk ka kërkuar mendim nga Komisioni shtetëror. Më pastaj, parashtruesi thekson se si pasojë e këtij vendimi të komisionit në fazën e tretë të selektimit – intervjusë, kundërkandidati ka marrë më shumë pikë që të rangohet e para që të mund të zgjedhet si kandidatë për vendin e punës së shpallur dhe të pranohet në punë.

Parashtruesi kërkon nga Komisioni shtetëror që t'i siguron të gjitha faktet dhe dëshmitë nga procedura, të merr vendim për ekzistimin e konfliktit të interesave, që ta anulon vendimin për zgjedhje dhe për këtë ta informon Komisioni për selektim të Agjencionit për administratë, të komunës dhe parashtruesin për këtë vendim.

Komisioni shtetëror, me qëllim të përcaktimit të akuzave nga denoncimim, deri tek komuna e ka kërkuar dokumentacionin e plotë nga zbatimi i Konkursit publik nr., vendimin për shpërndarje e udhëheqësit të Njesisë për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullim të tokës ndërtimore, veprime komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor në Komunën e dhe vendimin për shpërndarje në vendimin e punës të anëtarit të Komisionit për selektim nga kjo njësi.

Brenda afatit të caktuar me ligj nga ana e komunës së është dorëzuar dokumentacioni i plotë i kërkuar, nga e cila është konstatuar se:

Me kërkesë të Komunës nga ana e Agjencionit për administratë, konkursi për plotësim të 11 vendeve të punës me nëpunësve administrativ është shpallur konkurs me datë 22.06.2019.

Komisioni për selektim është formuar me Vendim miratuar nga ana e Agjencionit për administratë me datë 02.07.2019, i cili është në përputhje me nenin 37 paragrafi 4 nga Ligji për nëpunës administrativ.

Selektimi administrativ është bërë me datë 09.07.2019 në të cilën si pjesmarrës ka qenë edhe, si anëtarë i komisionit në cilësi të Udhëheqësit të Sektorit për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullim të tokës ndërtimore, veprime komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor, zhvillim lokal ekonomik dhe komunikacion, për vendin e punës nr. 01 Këshilltarë planifikues për të cilën është paraqitur edhe bashkëshortja e tij si një nga kandidatët.

Me datë 16.07.2019 ka dorëzuar kërkesë deri tek Njësia për resurse humane për tërheqje nga pozita e anëtarit të komisionit në të cilën ka paraqitur ekzistim të konfliktit të interesave, për të cilën është e informuar edhe Agjencioni për administratë, e cila ka marrë vendim për ndryshim dhe plotësim të vendimit paraprak për formim të komisionit për selektim në të cilën në vend të është vendosur – këshilltarë për rregullim të tokës ndërtimore, dhënje të kushteve për lokacion dhe miratim për ndërtim, në Njësinë për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullim të tokës ndërtimore, veprime komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

Në konkurs janë paraqitur 17 kandidatë nga të cilët 11 kanë pasur dokumentacion në rregull, kurse 6 kandidatë nuk i kanë dorëzuar dokumentat e nevojshme

Provimi për nëpunës administrativ është mbajtur me datë 22.07.2019 dhe nga kandidatët e thirrur janë paraqitur 9 prej tyre.

Në fazën tjetër – Intervju, janë paraqitur 6 kandidatë nga të cilët të dy kandidatët e paraqitur për vendin e punës nr. 01 sipas konkursit të shpallur.

Nga të gjitha fazat e selektimit të kandidatëve për vendin e punës nr. 01 kanë fituar këto pikë:

p. nr.	Kodi identifikues i kandidatit	Pikë nga faza e parë	Pikë nga faza e dytë	Pikë nga faza e tretë	Gjithsej pikë të fituara

1.	DADAD4C	7,80	38,2	20,00	66,05
2.	D5100EE	16,62	18,25	11,00	65,87

Propozimi për punësim të kandidatit të ranguar më mirë është dorëzuar deri tek Komuna e me datë 24.07.2019, kurse me datë 25.07.2019 nga Kryetari i Komunës së është marrë vendim për zgjedhje të kandidatit që ka fituar më shumë pikë që është prozuar nga ana e komisionit për selektivim.

Me datë 30.07.2019 nga ana e kandidatit të ranguar i dytë për vendin e punës nr. 01 nga konkursi i shpallur dhe në këtë rast parashtuesi i denoncimit deri tek Komisioni shtetëror, dorëzoi Ankesë deri tek Agjensioni për administratë. Komisioni i Agjencionit për administratë për vendosje për ankesa të nënpunësve administrativ të shkallës së dytë me datë 20.08.2019 morri vendim me të cilin ankesa e rrefuzohet, kure vendimi për zgjedhje të kandidatit e shpallur për vendin punës vërtetohet.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të konstatuar, Komisioni shtetëror nuk vërtetoi shkelje të nenin 73 nga LPKKI, sepse nuk janë vërtetuar mbulimi i interesit privat nga ana e personave zyrtar, në këtë rast të, Udhëheqës në Sektorin për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullim të tokës ndërtimore, veprime komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor, zhvillim lokal ekonomik dhe komunikacion në Komunën e, duke pasë parasyshë faktik se personi ka dorëzuar kërkesë deri tek Njësia për resurse humane për tërheqje nga anëtar i komisionit për selektivim për Shpallje publike nr., me çka e ka paraqitur interesin privat dhe është përjashtuar nga diktumimi dhe vendimmarrja në procedurën e mëtejshme.

Në bazë të të shënuarës mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimit.

KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të senacës së KSHPK
Përpunoi: S. M., këshilltarë
Miratoi: N. B., anëtarë i KSHPK